



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 09.10.2017, mori këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Vendimi për mbështetje financiare për z. Fadil Isak Gashi, me nr. personal 100404707, nga fshati Busi, si pasojë e djegies së stallës.
- II. Shuma e mbështetjes financiare e cekur në pikën I të këtij Vendimi, do të jetë 10.000 € (dhjetë mijë euro).
- III. Pagesa e shumës së cekur në pikën II të këtij vendimi, do të bëhet në xhirollogarinë bankare me numër 1300271100281308, në Bankën Private të Biznesit - BPB.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali i hartuar më 06.10.2017 nga zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë, të cilët kanë konstatuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore sipas kërkesës 12-321/01 nr. 0250709/17 e dt. 06.10.2017.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorja e Financave e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-422/01-0254815/17, më 11.10.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.